



Hekurudhat e Kosovës

Data: 15.12.2023

Në bazë të nenit 17, paragrafi 3, pika 1 të Statutit të Kompanisë me Nr. I/36 të dt. 20.04.2023, dhe në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, UD. Kryeshefi Ekzekutiv shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

Titulli i pozitës së punës: Udhëheqës i Zyrës Ligjore

Institucioni: Hekurudhat e Kosovës – Trainkos - SH.A.

Nr: referencë: 04 - 15.12.23

Tipi i Akt Emërimit të punës: Sipas Ligji Nr. 03/L-212 i Punës – Orar i plot i Punës

Titulli i mbikëqyrësit: Kryeshefi Ekzekutiv

Kohëzgjatja e kontratës: periudhë të caktuar: 1 (një) vite, me mundësi vazhdimi

Koeficienti/Kategoria: K – II

Procedura e aplikimit: I Brendshëm

Vende të lira pune: 1 pozitë (vend pune)

Vendi: Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon me resurset humane që posedon Zyra Ligjore;
- Drejton, planifikon dhe koordinon në mënyrë të drejtëpërdrejtë të gjitha aktivitetet e Zyrës Ligjore;
- Mbikëqyrë nga aspektet ligjore të gjitha vendimet e Menaxhmentit të Ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale të zyrave dhe Departamenteve përkatëse;
- Propozon politika për përmirësimin e proceseve ligjore brenda Ndërmarrjes;
- Në Bashkëpunim me Departamentët përkatëse, harton rregulloret dhe aktet tjera që zbatohen në nivel të Ndërmarrjes;
- Përfaqëson Ndërmarrjen në të gjitha çështjet ligjore pranë gjykatave dhe institucioneve tjera brenda dhe jashtë vendit;
- Kryen detyra tjera plotësuese nëse kërkohet nga Kryeshefi Ekzekutiv;
- Për punët e Zyrës harton raporte të rregullta;
- I raporton Kryeshefit Ekzekutiv.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathhtësitë e tjera:

- Të këtë të kryer shkollim Universitar, Fakulteti Juridik – Diplomë Universitare në Juridik;
- Preferohet të këtë Provimin e Jurisprudencës – Certifikata e dhënies së Provimit të Jurisprudencës;

- Te këtë 1 vite përvojë pune, pas përfundimit të Universitetit;
- Të ketë të bashkangjitur CV-në personale;
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme drejtuese;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Aftësi për të motivuar, organizuar dhe mbikëqyrë personelin;
- Aftësi të planifikoi dhe organizoi punën;
- Aftësi për të gjykuar dhe vendimmarrëse;
- Të jetë i sjellshëm dhe komunikativ;
- Aftësi për të punuar në grup dhe sjellje të shkëlqyer kolegjiale;
- Të jetë i aftë të punoj nën presion.

Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e Tërheqjes së Trenave në HK-Trainkos-SH.A apo në www.trainkos.com. Aplikacioni së bashku me dëshmitë të dorëzohen në ndërtesën e Tërheqjes së Trenave në HK-Trainkos-SH.A. në adresën Sali Puçolli Pn, në Fushë Kosovë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur, në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: **29/12/2023 ora 16:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk iu kthehen. Vetëm kandidatet e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

Fushë Kosovë
15.12.2023

UD. Kryeshf Ekzekutiv

[Signature]
Agron Statovci

